

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për Krime të Rënda, si penale, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarit Xheladin Osmani, si kryetar dhe gjyqtareve Ajser Skenderi dhe Nazim Vllaqo, si anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. S. nga fshati N., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 230 par.4 nep.4.2 lidhur me par.3 nenp.3.3 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.186/2015 e dt.16.12.2015, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datën 21.05.2018, dhe 03.09.2018, në prezencën e prokurorit të shtetit Mehdi Sefa të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. S. M., më datën 06.09.2018, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**I AKUZUARI:**

S. S., nga i ati E. dhe e ëma H., me mbiemër të vajzërisë M., i lindur më dt.*data e lindjes...*, në fshati N., Komuna e Suharekës, ku edhe banon, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, pa shkollë, ka të kryer tri klasë të shkollës fillore, pensioner, dinë me shkrua vetëm emrin dhe mbiemrin, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike.

A K T G J Y K I M

Në bazë të nenit 364 par.1 nenp.1.3 të KPPRK

LIROHET NGA AKTAKUZA

Se me 15 dhjetor 2014 rreth orës 21:00-21:30 dhe vazhdim gjerë në mars të vitit 2015 në fshatin N., KK Suharekë i akuzuari duke shfrytëzuar situatën në të cilin viktimja është e pa mbrojtur dhe siguria e saj është në rrezik me përdorimin e forcës detyron F. H. që në shtëpinë e saj të kryej akt seksual pa pëlqimin e saj, në atë mënyrë që shkon në shtëpinë e saj duke shfrytëzuar momentin e volitshëm mos prezencën e prindërve pasi kanë qenë në R., e mbyllë derën, hyn në kuzhinë, hekë xhezven nga dora e viktimës dhe me përdorim të forcës fillon me ia desh teshat F. H., duke i shqyer ato me force kështu që pa pëlqimin e saj kryen aktin seksual, duke vazhduar marrëdhëniet seksuale të kohë pas kohëshme, me viktimën gjerë në mars të vitit 2015 përmes shantazheve dhe kërcënimeve se ka me të dëmtuar nënën e saj.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale dhunimi nga neni 230 par. 4 nën par. 4.2 lidhur me par. 3 nën par. 3.3 të KP-së.

E dëmtuara F. H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.nr.186/2015 të dt.16.12.2015, kundër të akuzuarit S. S. nga fshati N., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 230 par.4 nep.4.2 lidhur me par.3 nenp.3.3 të KP-së, aktakuzë të cilën gjatë shqyrtimeve kryesore e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Mehdi Sefa.

Prokurori i shtetit – Mehdi Sefa në fjalën e tij përfundimtare, të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 06.09.2018, thekson: se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin kryesor me datën 24.04.2017, ndaj këtu të akuzuarit S. S., për veprën penale të përshkruar si në dispozitivin të aktakuzës duke theksuar që edhe gjatë shqyrtimit edhe në eliminimin e të gjitha fakteve kontestuese dhe duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, në tërësi është vërtetuar se në veprimet e këtu të akuzuarit S. S., formohen elemente të veprës penale të dhunimit, nga deklarata e të dëmtuarës F. H., prindit – dëshmitarit V. H., si dhe nga raporti i ekspertimit të Agjencionit të Kosovës për Forenzikë të datës 12.12.2015 si dhe pas dëgjimit të hartuesit dhe të përpiluesit B. M., si dhe ekspertit A. H. është vërtetuar në tërësi gjendje faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës se këtu i akuzuari S. S., prej Dhjetorit të vitit 2014 e deri në Mars të vitit 2015, pa pëlqimin e të dëmtuarës F. ka pasur marrëdhënie seksuale duke shfrytëzuar situatën kur ka qenë e pambrojtur dhe vetëm në shtëpi dhe duke përdorur gjithnjë sipas të dëmtuarës edhe forcë, andaj kërkohet nga trupi gjykues që të njëjtin ta shpallë fajtor për veprën penale të kryer dhe ta dënojë sipas ligjit.

Deklarata e këtu të akuzuarit S. S. se nuk ka pasur marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën F., gjykata nuk duhet të jep besueshmëri nga se kjo deklaratë është në kundërshtim të plotë me raportin laboratorik të Agjencionit të Kosovës për Forenzikë, ku pas marrjes së profileve nga i akuzuari S. S. dhe fëmijës të cilën e ka lindur F. H., është vërtetuar si baba biologjik me përqindje të besueshme 99.99% është këtu i akuzuari S. S., kështu që raporti laboratorik është në përputhje të plotë me deklaratën e F. H. si e dëmtuar si dhe dëshmitarit V. H..

Më datë 26.04.2017, kjo gjykatë të akuzuarin S. S. e ka shpallur fajtor për veprën penale dhunimi nga neni 230 par. 4 nën par. 4.2 lidhur me par. 3 nën par. 3.3 të KP-së dhe ia ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve ku i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.06.2015 deri më datën 25.12.2015.

Kundër këtij aktgjykimi, prokurori i shtetit Gjykatës së Apelit të Kosovës ia ka parashtruar ankesën për shkak të vendimit mbi dënimin, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit S. S., avokati S. M. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar. 1.12 të KPP-së, shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par. 1 nënpar. 1.1 dhe 1.2 të KPP-së si dhe për shkak të sanksionit penal – vendimi mbi dënimin.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me datën 11.07.2017, me aktvendimin e saj ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S. S., dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.233/15 të datës 26.04.2017, ka anuluar dhe çështjen ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Sipas Gjykatës së Apelit ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe sipas detyrës zyrtare me pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë përmban

shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par. 1 nënpar. 1.12 të KPP-së, e të cilat shkelje konsistojnë me faktin se gjykata nuk ka dhënë arsye të qarta përkitazi në fakte vendimtare dhe rrethanat të cilat paraqesin tiparet esenciale të veprës penale për të cilën i akuzuari është akuzuar dhe është shpallë fajtor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit deklaratat kontradiktore të dëmtuarës dhe dëshmitarit nuk paraqesin prova të besueshme për vërtetimin e veprimeve të të akuzuarit ashtu siç theksohet në dispozitivin e aktgjykimit dhe bëjnë që aktgjykimi të jetë i paqartë dhe juridikisht i paqëndrueshëm për vlerësimin e mëtejshëm, prandaj me dispozitat e nenit 402 të KPP-së, është anuluar aktgjykimi dhe çështja është kthyer Gjykatës të shkallës së parë për rigjykim.

Sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në pajtim, pra të eliminojë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës, të administrojë provat të cilat duhet vlerësuar komform neni 370 par. 7 të KPP-së, varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerrë konkludime të drejta dhe të bazuara në provat e administruara e pastaj të merret vendim përkatës në këtë çështje penale.

Provat në gjykim

I akuzuari S. S. nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale dhunimi nga neni 230 par.4 nep.4.2 lidhur me par.3 nenp.3.3 të KP-së, ashtu që gjykata pastaj ka administruar me provat: është bërë shikimi në raportin e Spitalit Rajonal në Prizren – Reparti i emergjencës nr.1575 të datës 23.06.2015 në fotografimin e ultrazërit të foshnjës së viktimës F. H., të datës 23.06.2015, në raportin e ekspertimit të Agjencionit të Kosovës për Forenzikë AKP/2015-3975/2015-3279 të datës 14.12.2015, së bashku në listën e dëshmimeve së bashku me dy tampona të marrur nga foshnja dhe dy tampona pambuku të marrë nga i akuzuari S. S.. Bëhet gjithashtu shikimi në dy raportet specialistit të datës 08.05.2016 me numër 1949 që ka të bëjë me S. S..

Duke pasur parasysh të gjitha këto vërejtje dhe rekomandime të Gjykatës së Apelit, serish ka hapur këtë çështje penale, dhe në shqyrtimin kryesor të datës 21.05.2018 ka ftuar me shqyrtimin kryesor ku ka dëgjuar të dëmtuarën F. H., në prezencën e psikiatrit, Dr. N. F., pastaj edhe në shqyrtimin kryesor ka dëgjuar edhe dëshmitarin – prinderin e të dëmtuarës, V. H.

E dëmtuara F. H., në prezencën e psikiatrit Dr. N. F., dhe pas konsultimit me të dëmtuarën deklaroi se e njëjta është në gjendje të përgjigjet në pyetjet e parashtruara qoftë nga prokurori, dhe deklaroi se qëndron në tërësi pranë dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor të dt.28.10.2016, duke shtuar se ka qenë muaji Dhjetor i vitit 2014 ku për herë të parë kam pasur marrëdhënie të dhunshme me të pandehurin S. S., dhe pastaj ka vazhduar nga muaji Mars, ka ardhur një herë në javë, pastaj edhe njëherë në dy javë e kështu me radhë, pra marrëdhënia ka zgjatur gjerë në muajin Mars të vitit 2015.

Në pyetjen e prokurorit se çdo herë këto marrëdhënie seksuale janë zhvilluar me dhunë apo jo me qejf në shtëpinë e juaj, e dëmtuara tha se çdo herë me dhunë. Rasti i parë në Dhjetor të vitit 2014 prindërit e mijë nuk kanë qenë prezent në shtëpi, kanë qenë në R.. S. S. ka ditur që prindërit e mijë nuk gjenden në shtëpi, sepse çdo herë ka përcjellë afër shtëpisë time, sepse shtëpinë e kemi larg diku 5 minuta në këmbë nga shtëpia e të akuzuarit.

Prej muajit Dhjetor të vitit 2014 e gjerë në muajin Mars të vitit 2015, S. S. çdo marrëdhënie seksuale me mua ka kryer duke përdorur dhunë, duke me kapur për flokë, për fyti, për krihe, ma ka shkye këmishën dhe atë si të shkyer e ka marrë me veti, se ku e ka lenë, ky e din, më ka kërcënua “kam me ta vras maminë ose vëllain V. H.” i cili për momentin gjendet në S..

Në pyetjen tjetër të prokurorit, se pse ju prej muajit Dhjetor e deri në muajin Mars nuk e keni paraqitur rastin në polici, ndërsa e keni paraqitur në muajin Qershor të vitit 2015, pse e keni pritur këtë kohë të gjatë, e dëmtuara deklaroj se ka pasur frikë për fjalët që mi ka thënë i akuzuari, çdo herë që shkojsha në market ose në Suharekë, të akuzuarin e kam pasur në vëzhgim non stop, unë në autobus për Suharekë, ky në autobus, unë jam friku gjersa babai i ka thënë mamit “që nuk është diçka në rregull me mu”, kështu që i kam treguar babait se me ka dhunu S. S..

Prej periudhës Dhjetor deri në Qershor kur kamë lajmëruar policinë, përveç me S. S., marrëdhënie me persona tjerë nuk kamë pasur.

E dëmtuara pastaj deklaroj se i akuzuari më ka premtuar se ka mem marrë për nuse për djalin e tij. Sa i përket Q. M., ai është nga fshati S., ai është shoku i babait tim, ndërsa M. K., është bashkëfshatar i imi dhe me këta persona nuk kamë pasur marrëdhënie seksuale.

E dëmtuara ka dhënë një deklaratë të saj në prokurori më dt.10.12.2015, ku ka deklaruar se e njeh M. H. nga fshati N. dhe Q. nga fshati S. dhe deklaroi se me këta persona kam pasur marrëdhënie seksuale, M. me ka kërcënua se ka me i ba mamit tim diçka pasi që ai e qon në punë dhe me atë kamë pasur marrëdhënie seksuale gjatë muajit Prill, ndërsa me Q. kam pasur marrëdhënie kah muaji Maj, dhe në pyetjen e prokurorit se sot po deklaroni se me këta persona nuk keni pasur marrëdhënie seksuale ndërsa atëherë keni deklaruar se keni pasur marrëdhënie seksuale, cila është e vërteta, e dëmtuara deklaroj se qëndroj në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori ku kamë deklaruar se kamë pasur marrëdhënie seksuale me këta persona.

Në pyetjen e përfaqësueses av. B. B. se ma herët keni deklaruar se keni pasur marrëdhënie seksuale në mënyrë të dhunshme me këtu të akuzuarin, a të kujtohet, para fillimit të marrëdhënies seksuale se çka keni biseduar, e dëmtuara thotë se i akuzuari më ka thënë “se do të më marrë nuse për djalin e tij F. S.” dhe për dhuratë mi ka pru dy çerek lira prej arit. Më të akuzuarin kamë qenë edhe në Tiranë për me shkuar në spitalin Amerikan për kontroll për sy, dhe nuk kamë qenë e dyshimit se çka kishte për të më bërë këtu i akuzuari. Kamë qenë disa herë në shtëpinë e të akuzuarit me babain dhe me mamin në mbrëmje, babai ka pasur respekt ndaj këtu të akuzuarit kanë qenë të lidhur në mes veti, ka ndodhur që i akuzuari pesë herë në ditë të vinte në shtëpi dhe të afërmit kanë dyshuar se pse ky vjen aq shpesh në shtëpinë tonë. Edhe unë personalisht kamë qenë në shtëpinë e të akuzuarit, nuk më kujtohet sa herë kur gruaja e tij ka pasur nevojë që ti ndihmoj, ka ardhë dhe me ka ftuar që ti ndihmoj rreth punëve në shtëpinë e saj.

Pas rastit të aktit seksual unë përsëri kamë qenë në shtëpinë e të akuzuarit, kur i akuzuari ka dashtë të bëjë aktin seksual, në shtëpinë time kanë qenë ose babai ose gjyshja, kur ka ardhur i akuzuari me ka ftuar që unë të shkoj në shtëpinë e tij, për pesë minuta duke përsëritur kërcënimet që mi ka thënë edhe me herët. I akuzuari ka qenë vetëm në shtëpi ngase gruan e ka que të familja e vet në fshatin Rërnje, djalin e ka pas në punë, djalin tjetër e ka në Itali dhe çikat i ka të martuara, sa herë që ka dashtë me bo marrëdhënie me mua në shtëpinë time e kur ka qenë prezent në shtëpi, ky më ka ftuar në shtëpinë e tij, kjo ka ndodhur prej Dhjetorit të vitit 2014 gjerë në muajin Maj 2015.

Në pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit se a ke udhëtuar ndonjëherë me S. S. në Suharekë, e dëmtuara deklaroj se po, me veturë ku kemi qenë unë dhe i akuzuari S., me taxi veturë. Në Suharekë kamë shku të mjeku, kamë pasur probleme me lukthin, sepse në atë kohë kamë qenë e sëmur prej lukthit, kamë shku për shikim të mjeku, kjo ka qenë para aktit të dhunimit, para muajit Dhjetor të vitit 2014. Nuk më kujtohet se sa herë kamë pasur marrëdhënie seksuale me S. qoftë në shtëpinë e tij ose në shtëpinë time, veçse e di se shumë herë ka ndodhur qoftë në shtëpinë e tij apo në shtëpinë time. E di se S. në atë kohë ka pasur 65 vjet ku edhe në atë kohë ka dal në pension. Kur kamë pas marrëdhënie seksuale me S., ai nuk është vdeshur tërësisht, por vetëm panolleti ka vdeshur. Gjatë gjithë kohës kur kishim marrëdhënie seksuale, kamë reaguuar dhunshëm kamë bërtit, por i akuzuari ma ka mbyll gojën dhe gjatë asaj dhune ka pasur marrëdhënie seksuale. Marrëdhënia ka zgjatur 10-15 minuta, edhe gjysmë ore. Nuk i kamë tregu askujt gjerë në muajin Qershor nga se kamë pas frikë nga këtu i akuzuari, kamë pasur frik nga ai edhe që ta paraqes rastin. Për shtatzëninë unë kamë kuptuar në muajin Prill kur i akuzuari mi ka pru testet e shtatzënisë dhe tabletat pasi që kamë dhënë deklaratën në policin e Suharekës. Arsyeja se pse nuk kamë paraqitur rastin gjerë në muajin Qershor ka qenë se mami i ka tregu babit se diçka nuk është në rregull me mua gjatë ciklit menstrual, babai me ka thënë që kamë me të dërgu të mjeku dhe unë i tregova babit se me ka dhunua baca S., prej policisë më kanë dërgu të mjeku, te gjinekologu dhe aty kamë kuptuar se isha në muajin e gjashtë të shtatzënisë.

Me të akuzuarin S. siç deklarova në Suharekë kam qenë vetëm me te, atë tre muaj para rastit të ndodhjes. I akuzuari Sali më ka dërgu te mjeku ngase prindi im, babai ka punuar në shkollë dhe prindërit nuk më kanë lejuar me shku vetëm te mjeku, dhe të akuzuarin e kam konsideruar si gjysh.

Në rastin e parë siç kam deklaruar kur më ka dhunuar i akuzuari, ka qenë në shtëpinë time në dhomë, në kuzhinë ka pasur shilte, ka përdorur dhunën tek unë para se me shku në kuzhinë, unë isha në korridor duke bërë kafe, më ka kapur për krahu, për flokë dhe më ka shtyrë gjer në kuzhinë, aty i akuzuari ka filluar të zhvesh pantollat me një dorë, kurse me dorën tjetër ma ka kapur krahun e djathtë, është munduar të më zhveshë, unë nuk e kam lejuar, por ky ma ka shky këmishën, dhe gjatë marrëdhënies ma ka mbyllë gojën, më ka rrëzuar në shilte dhe aty me dorë ma ka mbyllë gojën, kur kam bërtite dhe kur përfundon akti seksual e kam parë veten me gjak dhe më ka kërcënuar nëse i tregon dikujt apo policisë, “ka me ta vra mamin ose vëllaun”.

Çdoherë që kam pasur marrëdhënie me të akuzuarin, i akuzuari më ka thënë “sa herë kam me ba akte seksuale me ty, ti do të vish me mua”, me kërcënime të vazhdueshme. Me të akuzuarin në Tiranë kam qenë para muajit dhjetor, një muaj para rastit të ndodhur.

Në pyetjen e anëtarit të trupit gjykues se gjatë kryerjes së aktit a ka përdorur dhunë i akuzuari, a ke pas lëndime të dukshme në ndonjë pjesë të trupit, e dëmtuara deklaron se jo, shenja nuk kam pasur në trup por e di se vetëm ma ka shtrënguar dorën. Unë kam tentuar me shty të akuzuarin por lëndime të dukshme atij nuk i kam shkaktua.

Përveç që më ka kap për krahu dhe për flokë, para këtyre veprimeve S. nuk i kam pa asgjë në dorë, por më ka thënë se e kam një allti, kam te shtëpia në garazhë, mjetet të forta apo të rrezikshme nuk ka pasur me vete, para dhe gjatë kryerjes së aktit seksual. Në fund e dëmtuara deklaron se marrëdhënie seksuale ka zgjatur 10-15 minuta.

Dëshmitari V. H., në shqyrtimin e fundit të mbajtur me datën 03.09.2018, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratave të dhënë në Prokurori të datës 21.09.2015 dhe para trupit gjykues në seancën e mbajtur me datën 28.10.2016, ku ka deklaruar: S. S., e njohë si bashkëfshatarë dhe jemi njohtë ma shumë në muajin tetor në vitin 2013, babai im F. H. tash i

ndjerë ka qenë punëtor i shkollës ku edhe punojë, është i cili është pensionuar në vitin 2004, pas tij ka filluar të punojë në vend të tij këtu i akuzuari S..

Në pyetjen e prokurorit a është e vërtetë se vajza e juaj F. ka shkuar në T. me S. S., dëshmitari tha, po, ka shkuar me dijen dhe lejen time.

Në shqyrtimin e fundit, në pyetjen e KTGJ se për çfarë arsye kanë udhëtuar për në Tiranë, dëshmitari tha se gjatë asaj kohe kur i akuzuari është shëruar për sytë, ka kërkuar nga unë dhe me tha se gjoja është spitali i fortë, sepse vajza lëngonte nga sëmundja e këmbës për shkak të shkoputjes së ligamenteve dhe më ka thënë se ama lejon vajzën për t'ia bërë një kontrollë. I kamë thënë se po sepse i kamë besuar dhe kjo është bërë me pëlqimin tim.

Më të akuzuarin S. S. kurrë nuk kemi pasur mosmarrëveshje dhe asnjëherë nuk ka kanosur familjen time, raportet familjare më atë, kanë qenë të mira.

Diku rreth muajit maj 2015 më tha shoqja se me vajzën – F. nuk është diçka në rregull, menstruacionet nuk janë tuj ardhë me rregull, bisedova me shoqen që le të kryhet procesi mësimor në fund të muajit qershor, dhe atë ditë ora 10:30 është kryer procesi i notave data ka qenë 24. qershor 2015 shoqen e kam pas tuj punu në fshatin T., me një fabrikë dhe u krye notimi dhe erdha në shtëpi isha tuj hangër bukë dhe menjëherë fillova me vajzën me bisedu se çka është puna jote nuk është në rregull me ty, dhe filloj me qajt çka ki që po qan sun bojke ball me më tregu dhe iu afrova afër dhe pyeta fillojë me qajt me zë më ka dhunu baca S. dhe në qatë moment nuk di pse nuk kam marr shok, jam shkatërruar prej jetës kërkon se kam pas afër veç unë dhe vajza e kam thirrë shoqen në telefon nuk më është përgjigjë ka qenë nzanun para maqinës – në punë ku punon nuk kam pasur mundësi tjetër veçse ta njoftojë policinë, e njoftova policinë dhe shkova me marrë shoqen time, e pruna në shtëpi i tregova se vajzën e ka dhunu baca S. – S..

Në pyetjen a e dini se S. S. e ka vizituar shtëpinë e juaj, pa prezencën tënde, dëshmitari: gjatë ditës kam kuptuar ndonjëherë po këtë e kam kuptuar nga njerka ime, duke më thënë se po vjen si shpesh qe ky njeri në shtëpinë tonë. Ka qenë rreth muajit mars vitit 2015, isha te motra në Suharekë me gjithë nusen e vëllait dhe njerken dhe me vajzën F., në ora 23:05 minuta në mbrëmje kur kam hy me kerr në oborr ky ish kon në ballkon të shtëpisë, në hyrje të derës së shtëpisë sime, ku në shtëpi s'ka qenë askush, dera e shtëpisë ka qenë e mbyllur.

Në prokurori kamë deklaruar se S. S. e kamë dërguar në Tiranë, me makinën time e kam dërguar S. në Suharekë Stacion të autobusëve ku kompania “E.” e herë kompania më duket “K.” ka bartur pasagjerë për në Tiranë, është mjekuar te mjeku te Dr. T., e shumë herë e kam dërguar në stacion të autobusëve dhe në mbrëmje kur është kthye prej Shqipërisë, e kam marrë prej stacionit në shtëpinë e vet. Arsyeja se pse ka shkuar S. në Tiranë ka qenë se siç më ka thënë edhe vet ai ka qenë kontrolle mjekësore për sy, e sa i përket pyetjes për Tiranë dhe me shpenzimet e mija, jo nuk e kam përcjellë në Tiranë por siç thash nga Stacioni i autobusëve dhe anasjelltas në shtëpinë e tij.

Në pyetjen tjetër të prokurorit a ka kërkuar S. S. për naj djalë të tij çikën e juaj F., dëshmitari tha po, më ka thënë për një nip të tij nga fshati S., e që jeton në Slloveni, unë i kam thënë jo, sepse çfarë është gjendja me shtaga, kush ma merr këtë vajzë, nga se këmbën të cilën e ka të lënduar ka pasur këputje të ligamenteve kjo ka ndodhur para 4 vite, kam vazhduar me mjekim Dr. S. B. në Gjakovë, zyrën e ka edhe në Prizren, disa herë në gips, disa herë terapi, përgjigja ime ka qenë që vajza ime nuk është në gjendje të martohet për nipin e juaj.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës av. B. B.: deklaruar se i keni shërbime këtu të akuzuarit gjatë shkuarjes së tij në Tiranë a na tregoni nëse mundeni pse për çfarë arsyeje i keni bërë ato shërbime S..

Dëshmitari: në fillim kam kuptuar dhe kam menduar S. si njeri i mirë të cilin mu afru edhe vendi i punës, nga se e kam zëvendësuar kohë pas kohe S. kur ka qenë në pushime mjekësore, mi ka pru disa fidanë, pemë për ti mbjellë në oborr, mi ka pru disa hardhit të rrushit të cilat i kam në oborr, kam 2 pemë hurma të cilat mi ka sjellë S. nga Shqipëria, dhe kam pasur një respekt si shok dhe si bashkëfshatar, dhe shumë kam pasur besim tek ai.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës: a ka pasur dyshime këtu dëshmitari për të akuzuarin të cilin e ka vërejtur një ditë në orës 23:00 në ballkonin e tij. Dëshmitari tha jo, veç më ka thënë se pse e keni lënë shtëpinë vet, unë i thash se si kam borxhe askujt kushdo që ma vjedhë unë e di që nuk i kam borxhe kërkuj dhe skam autorizua ty me ma ruajte shtëpinë dhe e kam përzënë nga shtëpia se pse ka ardhur nuk e kam pyetur nga se kam pasur një shoqëri me te dhe një farë lirie me te, pas 4 ditëve ora 21:10 minuta kam qenë në banjo shoqja më tha pasi dola prej banjos kalojë një njeri para dritareve tona jam veshur shpejtë dhe kam dalë kah rruga në anën e majtë s'është kërkush jam kthye mbrapa prapë te ballkoni i shtëpisë në anën e djathtë e kam një rrugicë të cilën tualeti i oborrit në qoshe të shtëpisë, papritmas kur e kam pa para WC-së këtu të akuzuarin S. S., më tha erdha me ndejtë, e pyeta se nga cila derë erdhe, derën që e kishte mbrapa shpijës e asaj rrugice që hyjsha ndërkohë edhe unë, e kam ngjitur edhe garazhën e kerrit, ka qenë e mbyllur dhe pyes kah erdhe ti kah kjo derë që ishte e mbyllur pastaj i kam thënë që largohu dhe zdu me të pa ma kurrë në oborrit tim. I akuzuari në shtëpinë time ka ardhur shpesh edhe ditën por edhe në mbrëmje.

Me kujtohet para datës kur ka shkuar F. bashkë me të akuzuarin S., në Tiranë më ka kërkuar leje i cili më ka thënë a bon me marr vajzën, që kish mjekë të fortë në Tiranë, pasi në atë repart kishte mjek të fortë dhe t'ia bëjmë një kontrollë vajzës – F., u pajtova me këtë që e ka thënë S. dhe ka shkuar S. me çikën time në Tiranë dhe askush tjetër përveç këtyre nuk ka qenë.

Gjithashtu dëshmitari deklaroi se nuk është e vërtetë kur i akuzuari gjatë marrjes së shënimeve personale ka deklaruar se nuk ka shkollë dhe nuk din shkrim e lexim, kjo nuk është e vërtetë, sepse i akuzuari S. ka të kryer shkollën fillore nga se këtë informatë e kam marrë nga drejtorja e arsimit në Suharekë. Gjithashtu thekson se në garazhën e automjetit kam gjetur edhe dy letra të shkruara, një ditë një, e pas 3 ditëve edhe një letër tjetër ku ka qenë e shkruar “në raste se ti tregon dikujt kam me ti qit emrat sa dashnor ke pas dhe atë në shtyllat e fshatit”, 2 letrat të madhësisë 20x15 njëra të madhësisë 10x10 i ofrohen trupit gjykues nga prokurori i shtetit. Këto letra dyshojë plotësisht se i ka sjellë këtu i akuzuari sepse shkrimi në letra nuk i ishte kthyer dhe i shkruar mirë jam bazuar dhe garantojë çdo shkresë – letër, ia njohë shkrimin mirë.

I akuzuari S. S., në mbrojtjen e tij deklaroi: qëndroj në tërësi pranë deklaratës time të dhënë në prokurorin Themelore në Prizren më dt.07.07.2015 si dhe në shqyrtimin kryesor të dt.31.03.2017 ku ka deklaruar se jam 68 vjeçar, dhe kam 5 fëmijë. Këtu më të dëmtuarën F. H. dhe familjen e saj nuk jemi afër me shtëpi, edhe pse jemi nga i njëjti fshat. Me babain e të dëmtuarës –V. H., sa i përket raporteve, nuk ma merr mendja që dikush ti ketë raportet më të mira se unë që kam pasur me V..

Av.S.M.: sipas aktakuzës ti po ngarkohesh që nga data 15.dhjetor 2014 dhe në vazhdim gjerë në mars të 2015 ke pas marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën F. a është e vërtetë kjo?

I akuzuari: nuk është e vërtetë. Në shtëpinë e të dëmtuarës kam qenë, por kur ka qenë prezent V.. Te V. në shtëpinë e tij kamë qenë për problemet e punës, pasi që unë punojsha si pastrues në shkollën fillore të fshatit kam shkuar në pushimin mjekësor, ndërsa V. më ka zëvendësuar në atë kohë.

Av.S.M.: gjatë kësaj kohe sipas aktakuzës a ka ndodhë ndonjë me shku në shtëpinë e V. dhe me qenë vetëm aty F.?

I akuzuari: kjo nuk ka ndodhur siç thash gjithmonë kam shkuar kur ka qenë V..

Kam pas rast me F. me udhëtu. Nuk e di me datë por kam udhtu me te për në Tiranë, dhe në darkë më ftojë V. dhe më tha se a ki me shku për Tiranë, unë i thash po dhe i tregova se në Tiranë po shkojë për kontrolle pasi që kisha problem me syrin e majtë, pas që hëngrëm darkë, V. më tha se pasi që ti po shkon në Tiranë a bon me marrë edhe çikën time F. me vete, unë i thash se unë e marrë por ka mundësi që çikën mund ta kthejë në kufi, sepse nuk mund me iu thanë se është çika ime. V. prej fshatit N. deri në T., pastaj ka ardhur autobusi i Prishtinës, dhe kemi hypur në autobus me F. dhe kemi shkuar në Tiranë. Kemi shkuar në një Klinik e syrit në Tiranë, pasi që jemi lajmëruar në sportel për kontrolle dhe aty kemi bërë vizitat si unë ashtu edhe F. për syrin. Në Tiranë kemi mbërritur rreth orës 11:00 kontrolla ka zgjatur nja gjysmë ore dhe me të njëjtin autobus jemi kthyer gjerë në fshatin R. aty na ka prit baba i vet dhe na ka dërgu mu dhe F. në fshatin N., gjithashtu deklaroi se gjatë tërë rrugës nuk ka ngrënë as nuk kanë pirë gjatë tërë udhëtimit. Pas një muaji pasi që u kthyem nga Tirana baba i të dëmtuarës V. më ka thirrë përsëri në darkë dhe më ka thënë dhe më pyeti se mos po del kah Suhareka i thash po dhe më tha që merre edhe F. me vete, për fotografimin e këmbëve për F. ndërsa unë për kontrolle për sy, aty kontrolli i F. ka zgjatur shumë shkurt edhe i imi shkurt kështu që afër vetëshërbimit “Viva” në Suharekë aty kemi qëndruar shumë shkurt unë e kam pi vetëm një kafe e F. një lëngë, ka ardhur V. na ka marrë me kerr dhe na ka kthye në fshat.

Me familjen e V. kamë komunikua gjersa kam qenë në marrëdhënie pune, pas daljes në pension nuk ka pasur vizita në familjen e V..

Se pse po më akuzojnë pikërisht mu, kjo e din – e dëmtuara.

Av.S.M.: a je i aftë me pas marrëdhënie sipas teje?

I akuzuari: jo, kjo është ndërprerë qe 3 vite.

PSH. sot deklarove qe në shtëpi të F. nuk ke hy kur nuk ka qenë prezent fare V., pse pranove me shku pa prindin e saj e more vetëm F.?

I akuzuari: me vet iniciativën apo me vet dëshirën e prindit këtu të dëmtuarës V. nga se siç thash në dy rastet më ka ftuar në darkë dhe më ka propozuar që të shkojë me vajzën e tij së pari në Tiranë e pastaj edhe në Suharekë.

Raportet e mija me V. dhe F. kanë qenë shumë të mira, ka ndodhur që V. te unë ka ardhur edhe dy herë në ditë.

Me F. nuk kam pasur marrëdhënie seksuale.

Sa i përket pështymës, dy herë në shtëpinë time kanë qenë një hetues kurse tjetri nuk e di dhe e kanë marrë pështymën nga unë dhe u larguan, i kam pyet se pse po ma merrni pështymën dhe më treguan se dyshojnë për vepër penale.

Se kur F. është shtatzëne, nuk e di, nga se nuk kam qëndruar me te, por kamë kuptuar ka lind F., kanë marrë vesh krejt katundi.

Shtëpitë, e imja dhe të dëmtuarës, edhe pse me metra nuk mund ta përcaktojë por prej shtëpisë time gjerë në shtëpinë e V. ka nja 4-5 minuta në këmbë.

Telefonin gjatë vitit 2013,2014,2015 nuk kam pas atëherë e as sot. V. ka pas telefon por unë jo. V. ka ardhur në shtëpinë time dhe më ka marrë gjithmonë si bashkëfshatarë jemi njohur qysh moti sepse jemi të të njëjtit fshat, puna na ka lidhur. Në shtëpinë e V. nuk e di sa herë kamë qenë, sa herë më ka marrë V. unë kam shku në shtëpinë e tij .

Në pyetjen e radhës së përfaqësueses së dëmtuarës: a ka qenë prezentë F. kur babai i saj tha me marrë në Tiranë, i akuzuari tha: të gjithë atë natë kanë qenë prezent, kanë qenë familjarët por edhe F..

Përf. B. B.: a mundet me tregu pasi që pak ma herët u deklarua se gjithmonë V. e paska thirre për darkë këtu të akuzuarin, po ky a e ka thirre najherë V. për darkë?

I akuzuari: për darkë unë nuk e kam thirre por kur ka ardhë kemi ngrënë, çka ka qëllua, si në shtëpinë e vet. F. nuk me ka treguar që është shtatzënë.

Në pyetjen e të dëmtuarës: a të kujtohet kur i ke bo 2 teste të shtatzënisë një test ma ka pru te shpija, kur e kam bë testin e ka marrë testin ka shku në M. te Dr.E., pasi është takuar me mjekun ka ardhë te shtëpia ma ka pru testin, ku në test më kanë dalë dy vija, pozitive, e ky më ka thënë nëse del një vi, je shtatzëne, nëse dalin 2 nuk je shtatzëne a është e vërtetë, i akuzuari tha jo, nuk është e vërtetë.

E dëmtuara: a të kujtohet kur ke ardhë te shtëpia ime në prani të familjes time je qu më ke përqafe në dy faqe më ke thënë je çika jem dhe qe ke me marrë nuse për F.?

I akuzuari: nuk është e vërtetë.

E dëmtuara: atë ditë që i ka prishë babi marrëdhënie me ty, kemi qenë te halla në darkë, dhe kur kemi ardhë te shpija, a keni qenë ju në hyrje të oborrit në banjo (WC), a ke qenë aty?

I akuzuari: jo, nuk është e vërtetë.

Nuk e ndiej veten fajtor nga se me asnjë veprim nuk e kam kryer veprën penale.

Vepra penale dhunimi nga neni 230 par.4 nenp.4.2 lidhur me par.3 nenp.3.3 të KP.

***par.1- kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet*.**

***Par. 4 kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në një ose më shumë rrethana në vijim, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.**

***Nenp.4.2 kryerësi e përdor forcën.**

***Lidhur me par.3 :kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual në një ose më shumë rrethanat në vijim, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.**

***Nenp.3 duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.**

Në bazë të një pjese të mbrojtjes së të akuzuari, deklaratës së dëshmitarit V. H. e posaçërisht nga deklarata e të dëmtuarës, duke u bazuar edhe nga provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës, nuk është vërtetua se i akuzuari S. S. me 15 Dhjetor 2014, ta këtë dhunuar të dëmtuarën F. H. dhe në kuptim të nenit 364, par.1 nenp.1.3 të KPP, gjykata të akuzuarin S. S. e liroj nga akuza, ngase nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari S. S. është i moshës 68 vjeçare dhe ka 5 fëmijë, i akuzuari dhe e dëmtuara F. H., janë nga fshati N. Komuna e Suharekës, babai i të dëmtuarës V. H. më të akuzuarin është njohtë ma shumë muajin tetor në vitin 2013, dhe raportet në mes të akuzuarit dhe babait të dëmtuarit V. H., kanë qenë të mira (deklarata e të akuzuarit dhe të babait të të dëmtuarit) dhe i akuzuari në shtëpinë e babait të dëmtuarës ka shkuar gjithmonë kur ka qenë babai i të dëmtuarës. Me familjen e V. ka komunikuar gjer sa ka qenë në marrëdhënie pune. I akuzuari ka pas rast me të dëmtuarën F. me udhtu edhe në Tiranë, dhe në Suharekë ku ka pasur nevojë e dëmtuara për shiqime dhe kontrole mjekësore, më dijen dhe lejen e babai të saj (në pyetjen e prokurorit a është e vërtetë se vajza e juaj F. ka shkuar në Tiranë me S. S., dëshmitari tha, po, ka

shkuar me me dijen dhe lejen time) Pas një muaji pasi që u kthyem nga Tirana baba i të dëmtuarës V. e ka ftuar përsëri në darkë dhe e ka pyet se mos po del kah Suhareka, i akuzuari i ka thënë se po dhe i thotë merre edhe F. me vete për fotografimin e këmbës.

Babai i të dëmtuarës V. H., diku rreth muajit maj 2015 ka biseduar me bashkëshorten e tij e cila i ka thënë, se me vajzën – F. nuk është diçka në rregull, menstruacionet nuk janë tuj ardhë me rregull, dhe më 24. qershor 2015 pas ka ardhur nga puna në shtëpi, duke ngrënë bukë, menjëherë ka filluar me vajzën me bisedu se çka është puna jote nuk është në rregull me ty, sipas dëshmitarit e dëmtuara ka filluar të qaj, babai i saj i ka then, “çka ki që po qan” sun bojke ball me më tregu dhe iu afrova thot afër dhe pyet fillojë me qajt me zë më ka dhunu baca S. dhe në qatë moment nuk di pse nuk kam marr shok, jam shkatërruar prej jetës kërkon se kam pas afër veç unë dhe vajza e kam thirre shoqen në telefon nuk më është përgjigjë ka qenë nzanun para maqinës – në punë ku punon nuk kam pasur mundësi tjetër veçse ta njoftojë policinë, e njoftova policinë dhe shkova me marrë shoqen time, e pruna në shtëpi i tregova se vajzën e ka dhunu baca S. – S..

Sipas të akuzuarit raportet me babait të dëmtuarës V. dhe F. kanë qenë shumë të mira, gjë që e vërteton edhe vet babi i të dëmtuarës kur thotë se me **të akuzuarin S. S. kurrë nuk kemi pasur mosmarrëveshje dhe asnjëherë nuk ka kanosur familjen time, raportet familjare më atë, kanë qenë të mira.**

Nuk ishte kontestues se e dëmtuara ka pasur marrëdhënie seksuale më të akuzuarin ku gjatë akteve seksuale ka mbetur shtatzëne, ku ka lindur djalit më dt.06.10 2015, në spitalin rajonal në Prizren dhe sipas bindjes së të dëmtuarës femiu biologjikisht i takon edhe këtu të akuzuarit S. S..

Për tu vërtetuar fakti, nga prokuroria më dt.13.10.2015, është lëshuar vendim për ekzaminimin dhe krahasimin të ADN-së, Agjensioni i Kosovës për Forenzikë më dt.14.12.2015 ka bërë raportin e ekspertimit, ku në fund kanë konstatuar:

1.Nga dëshmitë *Y.H (mostra standarde , pështymë nga foshnja) dhe *S.S (mostra standarde, pështymë nga S. S.) janë nxerrë profili i ADN-së, së foshnjës dhe profili i ADN-së së S. S..

2.Nga krahasimet e bëra në mes të profilit të ADN-së, nga foshnja (*Y.H) dhe profilit të ADBN-së nga S. S..(*S.S), rezulton se S. S. nuk mundë të përjashtohet si baba biologjik i foshnjës (*Y.H).

Gjasat që S. S. është baba biologjik i foshnjës është 99.99%.

Lidhur me këtë situatë të krijuar më dt.17.01.2017 ka ftuar dhe dëgjuar Dr.B. M. nga Agjencioni për Forenzikë të Kosovës. i cili me shkrim ka dhënë mendimin më dt.14.12.2015 i cili ka theksuar se duke marrë parasysh që ADN-ja e çdo personi është unike atëherë do të thotë se ekziston langu biologjik qoftë ai pështymë, gjak apo qime floku ADN-ja është e njëjtë ku përveç pështymës analiza e ADN-së mund të bëhet prej gjakut prej qimes së flokut e spermës, ashtit, indit e kështu me radhë. Në Institutin mundë të bëhen këto analiza që i përmenda. ADN-ja e një personi është e njëjtë do të thotë që nga lindja e tij deri në vdekjen e tij, kjo donë të thotë se analiza nuk ndryshon prej momentit të lindjes rritjes, pleqërisë e gjerë në vdekje, çka donë të thotë se profili i atij personi është i njëjtë.

Në pyetjen e prokurorit, metodën të cilën e keni përsosur – me pështymë me profabilitet sa është e saktë që vërtetohet atësia e një foshnje, eksperti tha se në rastin konkret do të thotë rezultoni të jetë 99.99% do të thotë gjasa që S. S. të jetë baba biologjik i foshnjës.

Sipas ekspertit nuk mund të thuhet 100% për disa arsye: pasi që i tërë gjenomi apo e tërë ADN-ja e një personi të caktuar nuk analizohet por analizohen 16 lokuse apo 16 vende në ADN-ë, si arsye e dytë nuk iu kanë marrë ADN-ja e gjithë individëve në botë për t'iu bërë reakuenca e aleneve (alenet janë gjenet) dhe për këto arsye ne asnjëherë nuk mund të themi 100% mirëpo japim shifrën sikurse në rastin që ka dalë 99.99%.

Sipas ekspertit ADN-ja e marrë nga pështyma është njëlloj sikur ta marrësh nga gjaku, ashti, sperma, etj.

Nuk ishte kontestues se e dëmtuara gjatë akteve seksuale ka mbetur shtatzënë, ku ka lindur djalnin më dt.06.10 2015, në spitalin rajonal në Prizren dhe sipas bindjes së të dëmtuarës femiu biologjikisht i takon edhe këtu të akuzuarit S. S..

Mirëpo për gjykatën ishte kontestuese se i pandehuri S. S. a ka detyru personin tjetër këtu të dëmtuarën F. H. për të kryer akt seksual pa pëlqimin e saj, a ka përdor forcën, a ka detyru të dëmtuarën për të kryer akt seksual, a e ka shfrytëzuar situatën, a ka qenë e dëmtuara e pa mbrojtur ku siguria e saj është në rrezik, ashtu siç i pandehuri akuzohet për veprën penale, dhunimi nga neni 230 par.4 nenp.4.2 lidhur me par.3 nenp.3.3 të KP.

Paragrafi 1 i nenit 230 si kusht për dhunimin përmend detyrimin e personit tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë dhe se forma themelore e kësaj vepre penale konsiston me detyrimin e personit tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqim. Gjithashtu vepra penale nga par. 1 është vepër e përbërë e cila përbëhet nga akti seksual dhe nga ndonjë formë detyrimi për ta kryer aktin seksual pa pëlqimin e subjektit në rastin konkret të viktimës. E dëmtuara F. H. në deklaratën e saj ka përmendur disa forma të detyrimit dhe përdorimit të forcës, tha se prej muajit Dhjetor të vitit 2014 e gjerë në muajin Mars të vitit 2015, S. S. çdo marrëdhënie seksuale me mua ka kryer duke përdorur dhunë, duke me kapur për flokë, për fyti, për krihe, ma ka shkye këmishën dhe atë si të shkyer e ka marrë me veti, se ku e ka lenë, ky e din, më ka kërcënua “kam me ta vra maminë ose vëllain V. H.” i cili për momentin gjendet në Slloveni, e që gjykata më asnjë provë nuk vërtetoj këto veprime të të akuzuarit S., ndaj të dëmtuarës F. H..

Sipas vlerësimit të trupit gjykues nuk mund ta aprovohet pretendimi i Prokurorisë sepse vepra penale e dhunimit nuk ka mbështetje në provat e administruara.

E dëmtuara F. H. lidhur me rastin ka dhënë disa deklarata duke filluar qysh në paraqitjen e rastit në polici, pastaj deklaratës së saj të dhënë në prokurori dhe dy deklaratat në shqyrtime kryesore, kanë qenë kundërthënëse dhe nuk ka ditur të shpjegoj kundërthëniet e deklaratave të saja. E dëmtuara në rastin e parë të paraqitur në polici ka deklaruar se nuk din saktësisht por në Mars të vitit 2015 derisa babai dhe nëna nuk kanë qenë në shtëpi, rreth orës 23:00 ka shkuar S. S. dhe nga e dëmtuara ka kërkuar që t'ia piqte një kafe dhe derisa ishte duke përgatitur kafën në kuzhinë i akuzuari e ka mbyllë derën me qelës dhe e ka dhunuar me forcë dhe me rastin e ndodhur nuk i ka treguar askujt për rastin dhe se nga dita e dhunimit nuk ka pasur cikël menstrual dhe ka dyshuar se ka mbetur shtatzënë me të akuzuarin. Pastaj e dëmtuara në deklaratën e saj ka vazhduar se i akuzuari e ka dhunuar në kuzhinë derisa ishte duke pjekur kafënë, i është afruar ka filluar ta prekë, ia ka desh teshat e pastaj e ka dhunuar dhe me që ishte

vetëm s'ka pasur mundësi të kërkojë ndihmë nga askush. E dëmtuara pastaj në deklaratën e saj vazhdon duke thënë se herën e dytë kur e ka dhunuar S. ka qenë një muaj pas, ka shkuar në shtëpi ku ishte vetëm duke i thënë se nëse bërtet kam me të bërë keq, e dëmtuara ka shkuar në kuzhinë siç thotë e ka marrë një thikë por i akuzuari ia ka hequr nga dora thikën dhe e ka dhunuar, dhe pse ka bërtite, askush nuk e ka dëgjuar. E dëmtuara pastaj thotë se në këto dy raste ka pasur akt seksual me S..

Pra e dëmtuara nuk ka qenë e sigurtë kur thotë se S. S. e kishte dhunuar në Mars të vitit 2015, e më parë deklaroi se Saliu e kishte dhunuar në Dhjetor të vitit 2014, ku mjeku e kishte konstatuar të njëjtin muaj kur ka mbetur shtatzënë, që do të thotë se deklaratat e saja janë kontraverze.

Prej muajit Dhjetor të vitit 2014 e gjerë në muajin Mars të vitit 2015, S. S. çdo marrëdhënie seksuale me mua ka kryer duke përdorur dhunë, duke me kapur për flokë, për fyti, për krihe, ma ka shkye këmishën dhe atë si të shkyer e ka marrë me veti, se ku e ka lënë, ky e din, më ka kërcënua “kam me ta vras maminë ose vëllain V. H.” i cili për momentin gjendet në Slloveni. Prej muajit Dhjetor të vitit 2014 e gjerë në muajin Mars të vitit 2015, S. S. çdo marrëdhënie seksuale me mua ka kryer duke përdorur dhunë, duke me kapur për flokë, për fyti, për krihe, ma ka shkye këmishën dhe atë si të shkyer e ka marrë me veti, se ku e ka lënë, ky e din, më ka kërcënua “kam me ta vras maminë ose vëllain V. H.” i cili për momentin gjendet në Slloveni.

Kontradiktore gjithashtu ishin edhe deklaratat e të dëmtuarës me deklaratën e babait të saj V. H.. Derisa e dëmtuara tha se i akuzuari më ka premtuar se ka mem marrë për nuse për djalin e tij, babi i saj V., deklaroj ndryshe, ku në pyetjen e prokurorit, a ka kërkuar S. S. për naj djalë të tij çikën e juaj F., dëshmitari **tha po, më ka thënë për një nip të tij nga fshati S.**, e që jeton në Slloveni, unë i kam thënë jo, sepse çfarë është gjendja me shtaga, kush ma merr këtë vajzë, nga se këmbën të cilën e ka të lënduar ka pasur këputje të ligamenteve kjo ka ndodhur para 4 vite.

Policinë e ka njoftu, në muajin Qershor, në momentin kur ka filluar ti rritet barku – stomaku, dhe prindërit i kanë thanë qa të shkojnë te mjeku për një kontrollë, te gjinekologu.

Në rastin konkret, problemi kryesor është vendosja e kufirit të çartë në mes të aktit seksual me pëlqim dhe atij që kryhet me përdorimin e detyrimit ose mosekzistimi i pajtimit – pëlqimit gjatë ndërmarrjes së aktit seksual.

Neni 230 para. 1 i KP-së, kushdo që detyron personin tjetër

Teoria dhe praktika gjyqësore kanë paraparë kriteret e caktuara për vërtetimin e formës dhe intensitetit të detyrimit të cilat duhet të paraqiten si kusht për të ekzistuar vepra penale dhunimit.

Në pikëpamjet e intensitetit të forcës apo dhunës, kërkohet që ajo të jetë e atillë, e përshtatshme për ta thyer rezistencën e ofruar dhe të pritur nga kryerësi. Këtu mungon finalizimi detyrimit të drejtuar ka viktima, për këtë edhe nuk ka dhunim në rastin konkret. Detyrimi duhet të jetë patjetër direkt, që të ekzistojë për kryerjen e aktit seksual, nuk ka vepër penale të dhunimit gjersa detyrimi ka paraprirë në një mënyrë tjetër para kryerjes së aktit seksual.

Vërtetimi i formës së duhur dhe intensiteti i detyrimit është pyetje thelbësore për ekzistimin e veprës penale të dhunimit dhe këtu paraqiten në disa situata në mes të cilave duhet të ekzistojnë kufijtë e saktë. E para, akti si rezultat i përdorimit të detyrimit, e dyta, është akti i kryerjes pa dëshirën e viktimës, mirëpo pa përdorimin e dhunës sepse duhet konstatuar se dhuna duhet të jetë absolute e cila direkë mundëson veprimin seksual.

Qëndrimi i kësaj gjykate në rastin konkret është se nuk kemi të bëjmë me veprën penale të dhunimit, ngase i pandehuri nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprime të dhunës ndaj të dëmtuarës me rastin e kryerjes së aktit seksual me dhunë.

Nga neni 230 – dhunimi është përfshirë par. 4 pika 4.2- kryerësi e përdor forcën. Forca duhet të përdoret ndaj personit ndaj të cilit kryhet akti seksual të cilën mund të mposhti rezistencën e subjektit pasiv – viktimës, forca e cila përdor duhet të jetë i atij intensiteti sa që ta mposht rezistencën e viktimës, e rezistenca duhet të jetë serioze, e vërtetë dhe vazhdueshme por jo formale, apo një rezistencë e komolluar- e fshehtë.

Gjykata nuk mundi ta vërtetojë se në aktin seksual me të dëmtuarën apo viktimën të ketë përdorur forcë qoftë direkte apo indirekte, duke pasur parasysh tek e dëmtuara qysh në aktin e parë seksual nuk ka pasur ndonjë dëmtim qoftë edhe truporë gjatë kryerjes së aktit seksual, nuk ka pasur shenja të dhunimit, e po qe se kishte pasur ato do të ishin barem në një pjesë të dukshme të ndonjë lëndimi gjatë rezistencës e që e kishin për ta parë edhe anëtarët e tjerë të familjes, duke pasur parasysh se marrëdhëniet seksuale e dëmtuara me të akuzuarin ka pasur prej muajit Dhjetor të vitit 2014 gjer në fund të muajit Mars të vitit 2015 dhe se e **dëmtuara në deklaratën e dhënë prokurori më dt.10.12.2015, vet ka deklaruar se e njeh M. H. nga fshati N. dhe Q. nga fshati S. dhe deklaroi se me këta persona kam pasur marrëdhënie seksuale, siqë tha me M. gjatë muajit Prill, ndërsa me Q. kam pasur marrëdhënie kah muaji Maj.**

Prokurori i çështjes ka përfshirë edhe par. 3.3 të nenit 230, *duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik*.

Nga vetë deklaratat e të dëmtuarës dhe prindit të tij, e dëmtuara nuk ka qenë e pambrojtur sepse në shtëpi përveç prindërve të aftë ka pasur edhe gjyshen e saj, ka pasur vëllain e saj. I akuzuari shpesh ka shkuar në shtëpinë e prindërve të të dëmtuarës, por edhe e dëmtuara siç ka deklaruar vet ka shkuar në shtëpinë e të akuzuarit, paraprakisht edhe duke udhëtuar së bashku me të dëmtuarën për në Tiranë, në kontrollat e ndryshme mjekësore edhe në Suharekë, kështu që as e dëmtuara e as edhe prindi i saj nuk e paraqitën ndonjë shqetësim apo rrezik ndaj të dëmtuarit nga i akuzuari S., ngase vetë babai i të dëmtuarës-V. H. kur në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se a ka pasur ndonjë mosmarrëveshje me S., ka deklaruar se jo kurrë, a ju ka kanosur apo kërcënuar familjes suaj, ka deklaruar me jo dhe se raportet në mes juve dhe S. a kanë qenë të mira, gjithashtu ka deklaruar me po dhe kjo vërteton se e dëmtuara nuk ka pasur kurrfarë rrezikimi nga i akuzuari S. S..

Mbrojtjen e të e avokatit mbrojtës së të akuzuarit gjykata e hodhi si të pa bazuar sepse nuk ka mbështetje kur thotë se gjerë në muajin mars 2015 nga se përveç datës së theksuar 15.dhjetor data tjera nuk ka nuk dihet vendi nuk dihet koha ku dhe si në vazhdimësi ka pasur i akuzuari marrëdhënie seksuale me dhunë me të dëmtuarën, ndërsa në bazë të dëshmimeve vendi dihet (në shtëpinë e të dëmtuarës), koha gjithashtu dihet kur i akuzuari prej muajit Dhjetor të vitit 2014 e me përdorim të forcës dhe dhunës, e gjerë në muajin Mars të vitit 2015, me përdorimin e kanosjeve të vazhdueshme ka detyruar të dëmtuarën që më të akuzuarin të ketë vazhdimisht marrëdhënie seksuale dhe për pasoj e dëmtuara mbetet shtatzëne dhe në muajin Tetor lind fëmijun e saj. Gjykata gjithashtu e hodhi poshtë pretendimin e mbrojtësit se i akuzuari është person i pa përshtatshëm objektivisht për kryerjen e kësaj vepre penale nuk i plotëson kushtet shëndetësore për kryerjen e kësaj vepre penale me dhunë, ndërsa mjeku Dr. A. H. na vërtetoi të kundërtën, nga se gjatë kontrollimit fizik respektivisht kontrollin në organet gjenitale, ka bërë kontrollin fizik, gjatë shiqimit ka vërejtur se tek këtu i akuzuari ekzistojnë organet gjenitale.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës F. H., av.B. B. në fjalën e saj përfundimtare deklaron: në tërësi e mbështesë fjalën përfundimtare të prokurorit të PTH në Prizren, duke shtuar se gjendja faktike është vërtetuar posaçërisht në bazë të provave të cilat janë administruar në këtë çështje penale e citojë ekspertizën e Forenzikës të datës 14.12.2015 e cila fare qartë ka konstatuar gjendjen për atsinë e këtu të akuzuarit S. S., andaj kërkojë nga trupi gjykues që të merr një vendim të drejtë në bazë të të gjitha provave dhe të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptojë dënimin sipas dispozitave ligjore. Kurse lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar të dëmtuarës F. H., do të realizojmë në kontestin e rregullt civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. S., av.S. M., fjalën e tij përfundimtare gjykata ia parashtron me shkrim, e cila fjalën përfundimtare do të jetë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës dhe e aktgjykimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. S. M. fjalën përfundimtare e paraqiti me shkrim e cila është identike me atë që e ka dorëzuar më dt.24.04.2017 ku ka deklaruar: e kundërshtojë në tërësi aktakuzën sikurse në fjalën përfundimtare me shkrim konsiderojë se aktakuza si e tillë nuk mund të qëndrojë nga se është e përgjithësime që nga fillimi, unë nuk ka di ku ka mbështetje aktakuzën për periudhën kohën prej datës 15.12.2014, gjerë në muajin mars 2015 nga se përveç datës së theksuar 15.dhjetor data tjera nuk ka nuk dihet vendi nuk dihet koha ku dhe si në vazhdimësi ka pasur i akuzuari marrëdhënie seksuale me dhunë me të dëmtuarën, andaj ky konstatim nuk mund të qëndrojë kjo duhet të argumentohet me fakte kjo edhe nga deklarata e të dëmtuarës nuk rrjedhë po ta lexojmë të njëjtën si në hetime ashtu edhe në shqyrtimin kryesor. E tërë kjo çështje mbështet në një analizë të bërë të ADN konsiderojë se kjo është një çështje krejt tjetër civile e cila me padi për vërtetimin apo mohimin e atësisë do të vërtetohet në një procedurë krejt tjetër, ndërsa sa i përket kësaj vepre penale konsiderojë se i akuzuari është person i pa përshtatshëm objektivisht për kryerjen e kësaj vepre penale nuk i plotëson kushtet shëndetësore për kryerjen e kësaj vepre penale me dhunë, i njëjti edhe me dëshirë vështirë e ka me krye këtë vepër penale, këto nuk po ia them në mënyrë paushallë andaj duke i pasur të gjitha këto parasysht pavarësisht rezultati të ADN, konsiderojë se nuk ka vepër penale të dhunimit andaj duhet këto dy gjëra të ndahen veç e veç, pa hy në të kaluarën e të dëmtuarës ajo është jeta e saj private mirëpo e njëjta na bien me dyshu ekzistimin e kësaj vepre penale nga ana e të akuzuarit i cili ka pasur udhëtime me te ka mund që ta dhunojë nëpër vende tjera e jo të hyjë në shtëpinë e saj të mbylli derën të zhveshi dhe me dhunë të kryejë vepër penale, në kushtet tona dhe rrethanat është shumë e palogjikshme, kjo në këtë mënyrë e dëmtuara është munduar me e mbulue marren pasi që ka mbetur shtatzëne mirëpo është mëkat ti mvishet të akuzuarit që nuk ka mundur objektivisht të kryejë nuk është kandidatë potencial për kryerjen e kësaj vepre penale andaj i propozojë gjykatës që të njëjtin ta lirojë nga aktakuza, e lidhur me fëmiun në fjalën do të zhvillohet një procedurë tjetër civile.

Në fund të shqyrtimit kryesor deklaroj se nuk është vërtetuar aktakuza e prokurorisë se i akuzuari S. S. të këtë kryer veprën penale të dhunimit dhe atë prej muajit Dhjetor 2014 gjërë në muajin Mars 2015 gjithmonë duke përdor forcën siç deklaroi e dëmtuara. Është i palogjikshëm ky konstatim i prokurorit, ngase moshë e të akuzuarit nuk lejon mundësin që i njëjti 3-4 muaj pa ndërprerë duke përdor forcën të këtë pasur marrëdhënie seksuale me zgjatje kohore prej 15-30 minuta, në këtë drejtim edhe Gjykata e Apelit jep vërejtje ku konstaton se duke pasur parasysht deklaratën e të dëmtuarës që është shumë kontradiktore dhe asnjëra nuk përputhet me njëra tjetrën, po ashtu duke pasur parasysht deklaratën e babit të saj V. H. i cili është kontradiktor dhe

jo bindës i cili në polici ka deklaruar se vajza e tij është dhunuar vetëm njëherë, e tani deklaron se marrëdhëniet kanë zgjatur 3-4 muaj . Marrë në tërësi i akuzuari duhet të lirohet nga aktakuza, meqë nuk ka prova se i akuzuari të këtë kryer veprën penale të dhunimit duke përdor forcën, mungon ky element i veprës penale, andaj propozon që të lirohet nga akuza.

Marrë në tërësi, trupi gjykues muar për bazë pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit S. S., av. S. M., ngase kërkesa dhe propozimet e tija të paraqitura në fjalën përfundimtare në formën e shkruar ishin të drejta dhe të arsyeshme dhe trupi gjykues me veprimin sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, gjatë shqyrtimeve kryesore me dëgjimin e serishëm të dëshmitarit dhe të dëmtuarës eliminoj të gjitha kundërthëniet dhe deklaratat kontradiktore të të dëmtuarës dhe duke pasur parasysh edhe mbrojtjen e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari S. S. duhet të lirohet nga aktakuza për veprën penale të dhunimit të paraparë me nenin 230 par. 4 nën par. 4.2 lidhur me para. 3 nën par. 3.3 të KP-

Në bazë të mbrojtjes së të akuzuarit, nga dëshmia e dëshmitarit V. H. e posaçërisht nga dëshmia kundërthënëse e të dëmtuarës F. H. dhe nga provat tjera materiale, nuk u vërtetua se i akuzuari S. S. ka kryer veprën penale të dhunimit nga neni 230 par.4 nenp.4.2 lidhur me par.3 nenp.3.3 të KP, nga se në veprimet e të akuzuarit nuk janë formuar elementet e kësaj vepre penale, për çka gjykata në kuptim të nenit 364 par. 1 pika 1.3 e liron nga aktakuza, ngase nuk është provuar se këtu i akuzuari S. S. të këtë kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi mbi kërkesën pronësore juridike u mur në kuptim të nenit 463 par.3 të KPP.

Vendimi mbi paushallit gjyqësor, gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 454 par.1 të KPP.

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit

**Sek.juridike,
Teuta Spahija**

**Kryetari i trupit gjykues
Xheladin Osmani**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
-Departamenti për Krime të Rënda
- PKR.nr.79/2017, më datë 06.09.2018**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.